Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 61 e 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar, të nenit 24, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 150/2014, të nenit 6/1, të ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, të ndryshuar, të nenit 1, të ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, të nenit 8, të ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Indeksimin në masën 1,6 për qind të:

a) pensioneve të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuara;

b) pensioneve sociale, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

d) shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33,



të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) shtesave mbi pension, të dhëna sipas neneve 38, 39 dhe 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 24, të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

e) pensione të caktuara dhe të rilogaritura me ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21, të këtij ligji;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar;

f) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruar të nëndetësve dhe palombarëve të Forcave Detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar,

gj) pensione të pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

h) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarje të industrisë ushtarake”;

i) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të

universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”;

j) pensioneve suplementare, të caktuara sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar.

2. Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, e përfshijnë edhe pensionet të cilat caktohen nga data 1.8.2016 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 31.7.2016, përfshirë edhe këtë datë.

3. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, datë 6.11.2014, që kanë datë fillimi deri më 31.12.2014, pas datës 1.8.2016 nuk do të jenë më pak se 12 635 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë në muaj dhe më shumë se 25 270 (njëzet e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë në muaj.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.12.2014, nuk do të jenë më pak se 8 652 (tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë në muaj, por jo më shumë se 12 635 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë në muaj.

5. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.8.2016 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 12 635 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve dhe të të ardhurave, të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”; nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr. 7703,



datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nr. 150/2014, datë 6.11.2014, me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshi edhe këtë datë, edhe pas indeksimit të pensionit të caktuar sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e çmimeve dhe kompensimin e të ardhurave mujore, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”; nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”; nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”.

7. Përfituesit e pensioneve të parakohshme sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.7.2016, përfshi edhe këtë datë, edhe pas indeksimit të pensionit të caktuar sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e çmimeve dhe kompensimin e të ardhurave mujore, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”; nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”; nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”.

8. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione me datë fillimi deri më 31.12.2014, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, pas indeksimit të pensioneve sipas pikës 1, të këtij vendimi, të jetë:

a) deri në 14 285 (katërmëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe ato të caktuara me ligjin nr. 150/2014, datë 6.11.2014;

b) deri në 13 785 (trembëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

c) deri në 9 342 (nëntë mijë e treqind e dyzet e dy) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; dhe nr. 477, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, me datë fillimi deri më 31.7.2016 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 14 285 (katërmëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

10. Pas datës 1.8.2016 të ardhurat minimale:

a) të personave që përfitojnë pensionet e plota të pleqërisë (përfshirë edhe ato të caktuara me ligjin nr. 150/2014, datë 6.11.2014), përjashtuar ato të caktuara sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të



ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe kompensime vetjake, me datë fillimi deri më 31.12.2014, nuk mund të jenë më të ulëta se 14 785 (katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë në muaj;

b) të personave që përfitojnë nga pensionet e caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe kompensime për çmimin e energjisë elektrike e për të ardhurat nuk mund të jenë më të ulëta se 9 542 (nëntë mijë e pesëqind e dyzet e dy) lekë në muaj dhe më të larta se 12 835 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë në muaj;

c) të personave, që përfitojnë pensione të parakohshme për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, dhe kompensime vetjake, nuk mund të jenë më të ulëta se 14 785 (katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë në muaj.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 662 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë) lekë, të përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 2016 dhe ndahen përkatësisht:

a) 650 000 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të pensioneve;

b) 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a.

12. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., për të nxjerrë udhëzues teknikë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 550, datë 27.7.2016

**PËR BARAZIMIN E MASËS SË
SHITESËS SË PENSIONEVE TË
POSAÇME SHTETËRORE, TË
CAKTUARA NË HARKUN KOHOR
1.10.1993–31.12.2014, DHE INDEKSIMIN E
PENSIONEVE TË POSAÇME E TË
SHITESËS SË PENSIONEVE TË
POSAÇME SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 429, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve”, të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në masën e pensionit maksimal, në harkun kohor 1.10.1993–31.12.2014, të cilat vazhdojnë të paguhen edhe sot, do të bëhen 24 872 (njëzet e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë në muaj, me kusht që shuma e kësaj shtese, bashkë me masën e pensionit të caktuar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, përjashtuar shtesën sipas nenit 33, të këtij ligji, të mos kalojë vlerën 49 744 (dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër) lekë në muaj.

2. Në të njëjtën masë do të kalojnë edhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave në harkun kohor 1.10.1993–31.12.2014, për familjarët e personit të vdekur, që merrte ose i takonte të merrte pension të posaçëm shtetëror ose shtesë pensioni të posaçëm.

3. Pas këtij ndryshimi, të gjitha pensionet e posaçme dhe shtesat e pensioneve të posaçme shtetërore, përfshirë edhe ato që nuk janë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, do të indeksohen me 1, 6%.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2016, përlllogariten në



shumën 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë dhe përballohen nga fondet e sigurimeve shoqërore, të parashikuara në buxhetin e shtetit për vitin 2016.

5. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të nxjerrë udhëzimet përkatëse teknike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.8.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 551, datë 27.7.2016

**PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË
VENDIMIN NR. 77, DATË 28.1.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KONTRIBUTET E DETYRUESHME
DHE PËRFITIMET NGA SISTEMI I
SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE
SIGURIMI I KUJDESHIT
SHËNDETËSOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve të nëntokës”, dhe të

ligjit nr. 9136, datë 1.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 5, e kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve suplementare të detyrueshme, të jetë nga 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë e deri në shumën e pagës bruto, sipas listëpagesës.

Paga referuese në zbatim të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, është paga bazë për titullin në institucionet publike, duke përjashtuar shtesat për funksion. Paga bazë për titullin të jetë paga mujore korresponduese, e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, në të cilin pasqyrohet trajtimi me pagë dhe shtesa mbi pagë i personelit të institucioneve publike të arsimit të lartë në momentin e derdhjes së kontributeve.”.

2. Pika 18/c, e kreut III ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18/c. Personat që kanë titullin shkencor “Profesor”, “Drejtnes kërkimesh”, “Profesor i asociuar”, “Mjeshtër kërkimesh”, kur punojnë në universitetet, shkollat e larta dhe Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, në masën 5 për qind të pagës referuese të titullit për të punësuarit në sektorin publik dhe 7 për qind të pagës referuese të titullit për të punësuarit në sektorin jopublik.”.

3. Në kreun IV bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 11, fjalët “... për vitin 2015 ...” zëvendësohen me “... për vitin 2016 ...”.

b) Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“12/1. Shumat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave të paguara për ato periudha që personat nuk i plotësonin kushtet e kriteret për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi dhe, për rrjedhojë, nuk përfitojnë subvencionin e buxhetit të shtetit, për pagesat e kryera brenda pesë viteve nga data e konstatimit



apo data e kërkesës drejtuar organeve të sigurimeve shoqërore për kthimin e tyre, i kthehen atyre të plota. Këto shuma, me marrëveshje midis palëve, mund të konvertohen edhe si periudha sigurimi, në nivel minimal, në skemën e sigurimit shoqëror vullnetar, me kuotat e kontributit të kësaj skeme për vitet përkatëse korresponduese për të cilat ishte bërë sigurimi si i vetëpunësuar në bujqësi.

Në rastet kur nga data e pagesës e deri në datën e konstatimit apo datën e kërkesës drejtuar organeve të sigurimeve shoqërore kanë kaluar pesë vjet, me marrëveshje midis palëve, shumat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave të paguara konvertohen si periudha sigurimi në nivel minimal në skemën e sigurimit shoqëror vullnetar me kuotat e kontributit të kësaj skeme të viteve përkatëse korresponduese për të cilat ishte bërë sigurimi si i vetëpunësuar në bujqësi.

Procedurat e kthimit të shumave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave të paguara apo procedurat e konvertimit të tyre në kontribute në skemën e sigurimit shoqëror vullnetar përcaktohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.”

4. Në kreun VII bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 6 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për llogaritjen e bazës së vlerësuar mujore neto për punonjësit e dypunësuar merren në llogaritje pagat bruto mbi të cilat janë derdhur kontributet të realizuara në të dyja subjektet dhe zbritjet e bëra nga paga e punonjësit nga secili subjekt për shumat e kontributit, të sigurimeve shoqërore, të sigurimit të kujdesit shëndetësor, të sigurimit suplementar të detyrueshëm, si dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.”

b) Pas pikës 8 shtohen pikat 8/1 dhe 8/2, me këtë përmbajtje:

“8/1. Baza e vlerësuar, për efekt të llogaritjes së pensionit të pleqërisë për periudhën kur personi ka përfutur pension invaliditeti të grupit të parë dhe të dytë, para datës 1.1.1994, është paga referuese e përcaktuar në tabelat A1, A2 e A3 të vendimit nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, sipas llojit të punës së kryer para invalidizimit, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve. Baza e vlerësuar, për efekt të llogaritjes së pensionit të pleqërisë, për periudhën kur personi ka përfutur pension invaliditeti të plotë apo të

ardhura për invaliditet të plotë të përhershëm nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale pas datës 1.1.1994 deri në momentin e plotësimit të periudhës së detyrueshme të sigurimit sipas nenit 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, është shuma e bazës së vlerësuar mesatare mujore bruto, mbi të cilën është llogaritur pensioni i invaliditetit apo e ardhura për invaliditet të plotë, e indeksuar çdo vit me koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar, por, në çdo rast, brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të caktuar nga Këshilli i Ministrave, për efekt të pagesës së kontributeve të detyrueshme.

Njihet periudhë sigurimi, për efekt të përfutimit të pensionit të pleqërisë nga data 1.10.1993 e në vazhdim, periudha e trajtimit me pension të plotë invaliditeti, por shuma e viteve të punës para datës 1.1.1994 me vitet e sigurimit pas vitit 1994 dhe periudhën e trajtimit me pension të plotë invaliditeti nuk duhet të kapërcejnë periudhën e detyrueshme të sigurimit të përcaktuar në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, në momentin kur personit i lind e drejta për pension pleqërie.

8/2. Baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së pensioneve, për kohën e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë të jetë e barabartë me 4 302 (katër mijë e treqind e dy) lekë në muaj, e indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

Baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së pensioneve, për kohën e vuajtjes së dënimit me internim, kur internimi është dhënë si dënim penal plotësues, dhe dëbimit për kohën e vuajtjes së dënimit për të dëbuarit të jetë e barabartë me 3 494 (tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë në muaj, e indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

Në rastet kur paga referuese e llojit të punës, që kishte personi para fillimit të dënimit me heqje lirie, internim apo dënim, ishte më e lartë se masat e mësipërme, si bazë e vlerësuar, për efekt të llogaritjes së pensioneve për periudhën e dënimit, do të jetë paga referuese e llojit të punës para fillimit të dënimit, e përcaktuar në tabelat A1, A2 e A3 të vendimit nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, e indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.”

5. Në kreun VIII bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:



a) Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

i) Në paragrafin e parë, fjalët "... nga data 1.8.2015 e në vazhdim, të jetë 12 436 (dymbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) ...". zëvendësohen me "... nga data 1.8.2016 e në vazhdim, të jetë 12 635 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) ...".

ii) Në paragrafin e tretë, fjalët "... 14 086 (katërmëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj" zëvendësohen me "... 14 285 (katërmëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë në muaj ...".

c) Pika 4 riformulohet, si më poshtë vijon:

"4. Shuma bazë e pensionit, për personat që plotësojnë periudhën e sigurimit, sipas përcaktimeve në nenin 92 të ligjit, kur e drejta për përfitim lind nga data 1.8.2016 e në vazhdim, përfshi edhe këtë datë, të jetë 6 858 (gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë. Për llogaritjen e pensionit individual, shuma bazë, e përcaktuar si më lart, shumëzohet me vitet dhe muajt e sigurimit, që personi ka arritur nëpërmjet derdhjes së kontributeve dhe pjesëtohet me vitet dhe muajt e sigurimit, të përcaktuara në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, që i referohet vitit të lindjes të së drejtës për pension. Kur periudha e sigurimit, që personi ka arritur nëpërmjet derdhjes së kontributeve, rezulton edhe në ditë, ditët konvertohen në muaj, sipas rregullit që, 1 muaj ka 30 ditë."

ç) Në pikën 5, fjalët "... nga data 1.8.2015 e në vazhdim, të jetë 8 516 (tetë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë)" zëvendësohen me "... nga data 1.8.2016 e në vazhdim, të jetë 8 652 (tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) ...".

d) Në pikën 6, pas fjalëve "... nga viti 1994 e deri në mbushjen e moshës për përfitimin e pensionit ..." shtohen "... për aq kohë sa vazhdojnë të kenë kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi sipas këtij vendimi ...".

dh) Pas pikës 7 shtohen pikat 8 dhe 9, me këtë përmbajtje:

"8. Në zbatim të pikës 3, të nenit 32, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, shtesa mbi shumën bazë të pensionit të pleqërisë, e llogaritur sipas pikës 2, të këtij neni, është e barabartë me 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar mujore, e llogaritur sipas nenit 59 të ligjit. Nëse periudha e përgjithshme e

sigurimit të personit nuk është me vite të plota por edhe me muaj dhe ditë sigurimi, për efekt llogaritjesh, numri i ditëve faktike, që rezultojnë mbi numrin e viteve të plota, do të konvertohen në vit duke e pjesëtuar numrin e këtyre ditëve me 365. Në të njëjtën mënyrë përlllogariten edhe shtesat mbi shumën bazë në llojet e tjera të pensionit.

9. Për përlllogaritjen e bazës së vlerësuar për efekt përfitimi nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe për përfitime nga sistemi i sigurimeve shëndetësore njihet edhe shuma e kontributeve të derdhura për llogari të personit në zbatim të një vendimi gjyqësor, pavarësisht se detyrimi i subjektit punëdhënës mund të jetë më i madh dhe përmban edhe detyrime ende të papaguara për të punësuar të tjerë. Procedurat e derdhjes dhe dokumentimit në bazat e të dhënave përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave."

6. Pika 1, e kreut IX, riformulohet, si më poshtë vijon:

"1. Përfitimet afatshkurtra për sëmundje, barrëindje dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale, në favor të të punësuarit, llogariten nga punëdhënësi, ndërsa, për personat fizikë, nga strukturat lokale të sigurimeve shoqërore. Fondet për mbulimin e këtyre pagesave transferohen nga llogaritë e sigurimeve shoqërore në llogarinë individuale të përfituesit, pranë bankave të nivelit të dytë, një herë në muaj, pas miratimit nga organet e sigurimeve shoqërore të listëpagesës. Procedura e kontrollit të listëpagesave dhe e miratimit të llogaritjeve përcaktohet me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.8.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 552, datë 27.7.2016**

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 230, DATË 13.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGESË TË QIRASË PËR DISA FAMILJE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “UNAZA E MADHE E TIRANËS, SEGMENTI “KOMUNA E PARISIT–RRUGA E KAVAJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2015, “Për buxhetin e shtetit për vitin 2016”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,

me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe të ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja 2/1, që përmban listën emërore të subjekteve që do të trajtohen me qira, që i bashkëlidhet vendimit nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen 2/2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Afati dyvjeçar për përfitimin e qirasë prej këtyre subjekteve nis nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 2/2

LISTA E SUBJEKTEVE QË TRAJTOHEN ME QIRA PËR STREHIM, NGA NDËRTIMI I UNAZËS SË MADHE TIRANË

(segmenti rrugor “Komuna e Parisit–Rruga e Kavajës”)

Nr.	EMRI, ATËSIA, MBIEMRI	SHËNIME
1	SUL KRUJA	Plotësim dokumentacioni
2	AHMET HAMDI KRUJA	Plotësim dokumentacioni
3	ANDREA RAMAZAN PANARITI	Plotësim dokumentacioni
4	BASHKIM KRUJA	Plotësim dokumentacioni
5	XHEMAL HAMDI KRUJA	Plotësim dokumentacioni
6	BUKURIJE YMER KRUJA	Plotësim dokumentacioni
7	LULZIM GANI GJOSHI	Plotësim dokumentacioni
8	KUJTIM ELES ZGURA	Plotësim dokumentacioni
9	NAIL AHMET TAFILAKU	Plotësim dokumentacioni
10	KUJTIM ADEM HYSMETA	Plotësim dokumentacioni
11	SHPRESA FADIL BLETA	Plotësim dokumentacioni
12	MYHYRIJE SAZAN YMERI	Plotësim dokumentacioni
13	YLLI HAMDI YMERI	Plotësim dokumentacioni
14	ILIR FADIL BYLYKU	Plotësim dokumentacioni
15	FLAMUR AVDILLARI	Plotësim dokumentacioni
16	ZAMIR BASHKIM DEMIRI	Plotësim dokumentacioni
17	EMILJANA NAZMI MUHARREMI	Plotësim dokumentacioni
18	KRISTIANO PETRIT VELIA	Plotësim dokumentacioni
19	TOMI PETRIT VELIA	Plotësim dokumentacioni
20	ROVENA PELLUMB ABEDINI	Plotësim dokumentacioni
21	DANJEL FUAT SHAKU	Plotësim dokumentacioni
22	SAIMIR RUKA	Plotësim dokumentacioni
23	SHABAN KODRA	Plotësim dokumentacioni
24	GEZIM RAMAZAN SHABA	Plotësim dokumentacioni
25	MIHAL ETHEM VILA	Plotësim dokumentacioni
26	IMIR ETHEM VILA	Plotësim dokumentacioni
27	ALEKS ETHEM VILA	Plotësim dokumentacioni
28	ARBION VELIA	Plotësim dokumentacioni
29	EDUART KADRI YMERI	Plotësim dokumentacioni
30	ARTAN NAIL TAFILAKU	Plotësim dokumentacioni
31	ARTUR NAIL TAFILAKU	Plotësim dokumentacioni



32	SAIMIR MURAT TAFILAKU	Plotësim dokumentacioni
33	AGRON MAHMUD SEFERI	Plotësim dokumentacioni
34	LULEZIM IBRAHIM BALLA	Plotësim dokumentacioni

Mbyllet me numër rendor 34

Shënim. Të gjithë personat që kanë emrat në këtë listë, para kryerjes së pagesës, nevojitet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Entit të Banesave Tiranë “Plotësimin e dokumentacionit”, si: certifikatë familjare (aktuale), kopje të dokumentacionit që disponohet në lidhje me objektin e prekur nga projekti i zbatimit të Unazës së Madhe Tiranë (segmenti “Komuna Parisit–Rruga e Kavajës”), vërtetim nga banka për numrin e llogarisë, si dhe një deklaratë noteriale e subjektit përfitues ku të deklarohej se deri tani nuk ka përfituar kompensim nga asnjë VKM i dalë për shpronësim, si dhe VKM-të e dala për trajtim me pagesë të qirasë, si dhe të deklarojë që nuk ka konflikt interesi me persona të tjerë në lidhje me trajtimin me qira.

VENDIM

Nr. 554, datë 27.7.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE “BURDULLIAS””, BASHKIA BERAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Zgjerimi i varrezave publike “Burdullias””, Bashkia Berat.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Berat.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerën e plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 2 730 (dy mijë e shtatëqind e tridhjetë) m², me vlerë 11 419 590

(njëmbëdhjetë milionë e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 11 419 590 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Berat, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Berat.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë Berat të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 2 730 (dy mijë e shtatëqind e tridhjetë) m² “truall”, për projektin “Zgjerim i varrezave publike “Burdullias”” të bëhet në favor të Bashkisë Berat.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

LISTA EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SHPRONËSIMIT, QË DO TË PËRDORET PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE “BURDULLIAS””, NË BASHKINË E BERATIT

Nr.	Emri, mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona Kadastrale	Sipërfaqja m ² truall	Çmimi në lek/m ²	Vlera në lek	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Feride Bego Myrifete Peshtani	4/157	8501	2730	4183	11 419 590	Konfirmim nga ZVRPP-ja me shkresën nr. 3209/1 prot., datë 19.8.2015
TOTALI						11 419 590	

**VENDIM****Nr. 555, datë 27.7.2016****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “SHKODËR–
HANI I HOTIT (SHTESA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Shkodër–Hani i Hotit (shtesa)”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “kultura bujqësore”, “drurë frutorë”, “truall” dhe “objekte”, prej 24 190 858 (njëzet e katër milionë e njëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh, nga të cilat:

- “arë”, me vlerë 11 694 651 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) lekë;

- “truall”, me vlerë 644 969 (gjashtëqind e dyzet e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë;

- “kultura bujqësore”, me vlerë 825 227 (tetëqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë;

- “drurë frutorë”, me vlerë 520 314 (pesëqind e njëzet mijë e treqind e katërmëdhjetë) lekë;

- “objekte”, me vlerë 10 505 697 (dhjetë milionë e pesëqind e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “arë”, “kultura bujqësore”, “drurë frutorë”, “truall” dhe “objekte”, prej 24 190 858 (njëzet e katër milionë e njëqind e nëntëdhjetë

mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6, dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe dhe Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe dhe Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe dhe Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR SIP. TOKË (ARË, TRUALL, PEMËTORE)
NË SEGMENTIN RRUGOR “SHKODËR–HANI I HOTIT”

Lista nr. 1

Listat nr. 1

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kad.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m²	VLERËSIMET									Vlera Totale	Shënime
								Toke arë			Tokë truall			Pemëtore				
								Sip. shpr. (m²)	Çmimi (l/m²)	Vlera (lekë)	Sip. m² Shpron.	Çmimi (l/m2)	vlera (leke)	Sip. m² Shpron.	Kult. bujq.	Dru frutorë		
1	Zenel	Bajramkurtaj		8592	322/6	Truall	160				43				19500		19500	Konf. nga ZVRPP-ja
2	Sherif	Rexhep	Harusha	1495	322/5	Truall	570				70				12000		12000	Konf. nga ZVRPP-ja
3	Zenel	Shaban	Isufi	3428	100/65	“Arë”,	13350	295							43000		43000	Konf. nga ZVRPP-ja
4	Fejzi		Dema	3428	161/24	“Arë”,	6200	87							8000		8000	Konf. nga ZVRPP-ja
5	Xhelal		Mehmeti	3428	120/20	“Arë”,	3690	82							30000		30000	Konf. nga ZVRPP-ja
6	Bardhyl		Musiqi	3428	338/22	“Arë”,	4376	93							11750		11750	Konf. nga ZVRPP-ja
7	Lutfi		Drini	3428	338/34	“Arë”,	11365	204							32500		32500	Konf. nga ZVRPP-ja
8	Haki		Drini	3428	338/33	“Arë”,	10480	112							40000		40000	Konf. nga ZVRPP-ja
9	Kimete Xhemal Halit	Ahmet Ahmet Ahmet	Islami, Erkoçevic, Islami	3428	338/20	“Arë”,	27720	522							44000		44000	Konf. nga ZVRPP-ja Konf. nga ZVRPP-ja Konf. nga ZVRPP-ja
10	Jonuz		Elezi	3428	338/18	“Arë”,	2970	287							38400		38400	Konf. nga ZVRPP-ja
11	Aferdita Edmond Medina Abesin Leonora Mirsad Mirsada	Set Skender Skender Skender Ahmet Alket Alket	Mahmuti Mahmuti Mahmuti Mahmuti Mahmuti Mahmuti	3429	101/81	Are	13100	112	270	30240							30240	Çertif.Pron.
12	Tome	Gjeke	Planaj	2827	88/1	“Arë”,	2120	30							9000		9000	Konf. nga ZVRPP-ja
13	Imer	Jakup	Nika	2827	5/6	“Arë”,	8300	518							38000		38000	Konf. nga ZVRPP-ja
14	Tahir	Hysen	Nikaj	1766	1060/26	“Arë”,	4879	60	208	12480							12480	Konf. nga ZVRPP-ja
15	Smajl Fatmir	Ali	Rexhaj	1766	1067/19	Truall	4300	680							89000		89000	Konf. nga ZVRPP-ja
16	Haxhi	Hysen	Çokaj	1766	1063/25	“Arë”,	5290	193	208	40144							40144	Konf. nga ZVRPP-ja
17	Bardhyl	Bisho	Hoti	1864	207/27	“Arë”,	3156	1409							127500	15600	143100	Konf. nga ZVRPP-ja
18	Vladimir	Vido	Ajković	1864	201/56	“Arë”,	8990	643							1200		1200	Konf. nga ZVRPP-ja
19	Fran	Zef	Paja	1864	201/4	“Arë”,	6100	250								1560	1560	Konf. nga ZVRPP-ja
20	Tome		Gjetja	1465	803/2	“Truall”	327				327	24	7848				7848	Konf. nga ZVRPP-ja
21	Izet	Aziz	Kashari	1465	557/5	“Arë”,	1148	230							13000		13000	Konf. nga ZVRPP-ja
22	Zekë	Zenel	Demiraj	1465	803/22	“Arë”,	2300	176	231	40656							40656	Konf. nga ZVRPP-ja
23	Halil		Gjetaj	1464	557/3	“Arë”		1330								373500	373500	Rikonfirmim
24	Galush	Halil	Gjetaj	1465	557/7	“Arë”,	6910	1272	231	293832							293832	Konf. nga ZVRPP-ja
25	Naim	Halil	Gjetaj	1465	557/6	“Arë”,	6920	642	231	148302							148302	Konf. nga ZVRPP-ja
26	Zekë	Zenel	Demiraj	1465	803/21	“Arë”,	2300	1219	231	281589							281589	Konf. nga ZVRPP-ja
27	Hajri	Isuf	Kozmaj	2299	428/12	“Arë”,	1050	539	208	112112							112112	Konf. nga ZVRPP-ja
28	Arben		Salihaj	2299	247	“Arë”,	29202	598							3360		3360	Konf. nga ZVRPP-ja
29	Rexhep	Salo	Dukaj	2299	258/6	“Arë”,	5500	2155								46880	46880	Konf. nga ZVRPP-ja
30	Nimete	Ramadan	Ramaj(kurtaj)	1238	1065	“Arë”,	4409	383							30000		30000	Konf. nga ZVRPP-ja
31	Maliq	Ram	Kurti	1238	699	“Arë”,	3523	1380								23774	23774	Konf. nga ZVRPP-ja
32	Rifat	Oso	Kurtaj	1238	504	“Arë”,	4490	1279	208	266032							266032	Konf. nga ZVRPP-ja
33	Ragip	Bajram	Kurtaj	1238	1049	“Arë”,	7968	1579	208	328432					24632		353064	Konf. nga ZVRPP-ja
34	Ragip	Bajram	Kurtaj	1238	611	“Arë”,	2940	702	208	146016							146016	Konf. nga ZVRPP-ja
35	Ragip	Bajram	Kurtaj	1238	615	“Arë”,	663	159	208	33072							33072	Konf. nga ZVRPP-ja



36	Sadik	Bajram	Kurtaj	1238	1036/3	“Arë”,	11317	1463	208	304304						304304	Konf. nga ZVRPP-ja
37	Sadik	Bajram	Kurtaj	1238	600	“Arë”,	11317	261	208	54288						54288	Konf. nga ZVRPP-ja
38	Sadik	Bajram	Kurtaj	1238	176/4	“Arë”,	3520	464	208	96512						96512	Konf. nga ZVRPP-ja
39	Sutki	Kadri	Kurtaj	1238	1056/2	“Arë”,	2735	1556	208	323648				108364		432012	Konf. nga ZVRPP-ja
40	Fadil	Haxhi	Kurtaj	1238	1060/1	“Arë”,	1400	783	208	162864						162864	Konf. nga ZVRPP-ja
41	Riza	Myrto	Kurtaj	1238	595	“Arë”,	3622	1747	208	363376						363376	Konf. nga ZVRPP-ja
42	Halil	Myrto	Kurtaj	1238	501/1	“Arë”,	2257	407	208	84656						84656	Konf. nga ZVRPP-ja
43	Sherif	Myrto	Kurtaj	1238	502	“Arë”,	4514	1422	208	295776						295776	Konf. nga ZVRPP-ja
44	Mustaf	Sokol	Kurtaj	1238	596/1	“Arë”,	6170	1256	208	261248						261248	Konf. nga ZVRPP-ja
